

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6164  
E premte, 13 nëntor 2020  
çmimi 0.40 €

BQK-ja parasheh  
rënie ekonomike prej  
7.2-përqindësh FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://www.facebook.com/Gazeta-Epoka-e-re/)

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

QEVERIA E KOSOVËS KA BËRË PUBLIKE MASAT E REJA  
KUNDËR PËRHAPJES SË PANDEMISË COVID-19

## OPINION

**KOSOVA DUHET T'I MBUSHË  
DHOMAT E SPECIALIZUARA NË  
HAGË ME KALLËZIME PENALE** F. 11

Bejtush ISUFI,  
avokat



**SATANIZIMI I UÇK-SË NGA  
SPECIALJA** F. 11

Faton  
MEHMETAJ



## AKTUALE

**SHQIPTOHEN 25 GJOBA  
MANDATORE PËR NDOTËSIT  
E MJEDISIT GJATË MUAJVE  
SHTATOR-TETOR** F. 7

**FSK-ja NDIHMION KOMUNAT  
PËR PËRBALLJE ME PANDEMINË  
COVID-19** F. 6



## EKONOMI

**'TREPÇA' KËRKON NDIHMË  
FINANCIARE NGA QEVERIA** F. 8

**FINALIZOHET PLANI PËR  
PËRMIRËSIMIN  
E INTEGRITETIT TË ATK-së** F. 8

## SPORT

**TË BASHKUAR MUND  
TË LUANIM NË KOMPETICIONET  
MË TË RËNDËSISHME** F. 14

# QEVERIA PËRPIQET TA FRENOJË COVIDIT, SOT ZBATOHEN MASAT E REJA ANTI-COVID

FAQE 4-5

## AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

Sot (e premte), me fillim nga ora 18:00, fillon zbatimi i masave të reja për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Masat e reja ndahen në tri zona të rrezikshmërisë, sipas numrit të të infektuarve nëpër

komuna: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët. Në komunat me rrezik të lartë të

përhapjes së infeksionit ndalohet lëvizja e qytetarëve jashtë shtëpive të tyre pas orës 19:00 e deri në orën 5:00. Masa strikte parashihen edhe për komunat që janë në zonën e portokalltë dhe në zonën e gjelbër

## ARRIHET MARRËVESHJA PËR NDËRTIMIN E RRUGËVE QË KALOJNË NË ZONËN E MANASTIRIT TË DEÇANIT

FAQE 3

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, në bashkëpunim me ambasadorin e Italisë, Nicola Orlando dhe me mbështetje të komandantit të KFOR-it, Michele Risi, kanë arritur marrëveshje për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e rrugëve të

cilat kalojnë nëpër Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit. Marrëveshja është thënë të jetë rezultat i diskutimeve për disa muaj në mes të Komunitetit të Deçanit dhe përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në Manastirin e Deçanit



## VJOSA OSMANI: PRES QË BE-ja DHE NATO-ja T'I PËRGJIGJEN KËRCËNIMIT TË VUÇIQIT

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Nju-Jorku vendos kufizime të reja për luftim të koronavirusit


NJU-JORK, 12 NËNTOR - Nju-Jorku ka prezantuar kufizime të reja për koronavirus, teksa numri i rasteve të infektimit rritet shpejt. Guvernatori Andrew Cuomo ka njoftuar se baret, restorantet dhe palestrat duhet të mbyllën në orën 10:00 të mbrëmjes dhe grupet mund të krijohen deri në 10 persona. "Ne po shohim një rritje globale të rasteve me koronavirus dhe Nju-Jorku është anije në

baticën e Covid-it", ka thënë Cuomo në një bisedë me gazetarët. "Ne po përballemi me rekorde në shtetin tonë. Situata është duke u përkeqësuar shumë çdo ditë", ka thënë ai. Kryetari i qytetit të Nju-Jorkut, Bill de Blasio, i ka përshkruar masat e reja si "mundësinë e fundit" për ta ndaluar valën e dytë. Masat e reja do të nisin së zbat-

uari më 13 nëntor. Nju-Jorku ka qenë epiqendër e pandemisë së koronavirusit në pranverë me gati 1 000 viktima në ditë, në fillim të muajit prill. Kufizimet e reja në Nju-Jork vijnë teksa shtetet e tjera janë duke u bërë thirrje njerëzve që ta trajtojnë me seriozitet përhapjen e koronavirusit, sidomos tani kur po afrohet Festa e Falënderimeve dhe ajo e Krishtlindjes.



## BE-ja, mbështetje shtesë prej 100 milionë eurosh programit për vaksinën kundër Covid-19



BRUKSEL, 12 NËNTOR - Komisioni Evropian ka njoftuar se do të sigurojë mbështetje shtesë prej 100 milionë eurosh për Programin e Qasjes Globale të Vaksinave (COVAX) për koronavirus. Presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, ka thënë se do të ofrojë më shumë kontribut ndaj mekanizmit të COVAX i cili synon qasje të drejtë

dhe të barabartë globale të vaksinës dhe e cila është formuar në Forumin e Paqes në Paris nën kryesimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Aleancës Globale për Vaksinat dhe Imunizimin (GAVI) dhe Koalicionit të Inovacionit për Përgatitje ndaj Sëmundjeve Epidemike (CEPI). "KE-ja më parë ka premtuar se do të

sigurojë një kontribut prej 400 milionë eurosh për COVAX", rikujtoi Von der Leyen, e cila njoftoi se për programin do të sigurohet një fond shtesë prej 100 milionë eurosh. Mekanizmi COVAX po zhvillon bisedime me prodhues të ndryshëm për blerjen e 2 miliardë dozave të vaksinës kundër Covid-19 deri në fund të vitit 2021.

## Bideni bën publik emrin e shefit të stafit në administratën e tij

UASHINGTON, 12 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur amerikan, Joe Biden, ka njoftuar se Ron Klain do të jetë shefi i stafit të tij në Shtëpinë e Bardhë. Kjo pozitë konsiderohet ndër më të rëndësishmet në një administratë amerikane. "Përvoja e thellë e Ron Klainit dhe kapaciteti për të punuar me njerëzit në gjithë spektrin politik është pikërisht ajo që më duhet në një shef të stafit në Shtëpinë e Bardhë teksa përballemi me një moment krize dhe bashkojmë shtetin edhe një herë tjetër", ka thënë Biden në një shkrim publikuar

në rrjetin social "Twitter". Përzgjedhja e Klainit reflekton prioritetet e administratës së ardhshme të Bidenit, e cila synon ta kthejë nën kontroll pandeminë e koronavirusit dhe ta menaxhojë turbulencën ekonomike. Klain ka qenë koordinator për përgjigjen ndaj Ebolas, gjatë shpërthimit të sëmundjes më 2014 në Afrikën Perëndimore dhe ka ruajtur rol në hartimin dhe zbatimin e rimëkëmbjes ekonomike më 2009 si pasojë e krizës financiare globale, në kohën kur president i Shteteve të Bashkuara ka qenë Barack

Obama. Ai ka shërbyer si shef i stafit për Bidenin gjatë mandatit të parë të Obamas dhe më pas ka qenë këshilltar në fushatën e Bidenit. Ai ka qenë, po ashtu, shef i stafit të nënpresidentit Al Gore në vitet 1990 dhe ka punuar në Kongres kur Bideni ka qenë senator. Shefi i stafit shpesh konsiderohet lidhje kyçe për të depërtuar te presidenti. Personi që ka këtë pozitë, po ashtu, zhvillon strategji politike dhe legjislative dhe shërben si bashkëpunues në Kongres në negociatat legjislative.



## Rezervat e uraniumit të pasuruar në Iran, 12 herë më të mëdha sesa që është përcaktuar

TEHRAN, 12 NËNTOR - Irani vazhdon t'i rrisë rezervat e uraniumit për t'u pasuruar përtej kufizimeve të përcaktuara në marrëveshjen bërthamore, që ka nënshkruar Teherani me fuqitë botërore, si dhe vazhdon ta pasurojë atë më shumë sesa i lejohet, ka thënë Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike më 11 nëntor. Ky trup ka thënë se në raportin e fundit është vërejtur se Irani deri më 2 nëntor ka krijuar rezerva prej 2,442.9 kilogramëve të uraniumit të pasuruar nga

2,105.4 kilogramë sa ishte raportuar më 25 gusht. Marrëveshja bërthamore e nënshkruar më 2015 mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Francës, Britanisë, Kinës dhe Rusisë, i mundëson Teheranit të krijojë rezerva për vetëm 202.8 kilogramë. Shtetet e Bashkuara janë larguar nga kjo marrëveshje më 2018. Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike ka raportuar se Irani ka vazhduar ta pasurojë uraniumin me shkallë 4.5 për



qind të pastërtisë, në krahasim me 3.67 për qind sa i lejohet me marrëveshjen bërthamore.

Kjo agjenci, po ashtu, ka thënë se sqarimet e Iranit për prani të materialit bërthamor në disa

zona të padëklaruar në këtë shtet "nuk janë të besueshme". Pavarësisht pse autoritetet iraniane kanë ofruar disa informacione për këto zona "agjencia e ka informuar Iranin se vazhdon ta konsiderojë përgjigjen e Teheranit si teknikisht jo të besueshme", ka thënë raportin. Ndonëse agjencia nuk ka identifikuar vendin me material bërthamor, burimet diplomatike kanë thënë se bëhet fjalë për rajonin Turqzabad në Teheran.

# Arrihet marrëveshja për ndërtimin e rrugëve që kalojnë në zonën e Manastirit të Deçanit

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, në bashkëpunim me ambasadorin e Italisë, Nicola Orlando dhe me mbështetje të komandantit të KFOR-it, Michele Risi, kanë arritur marrëveshje për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e rrugëve të cilat kalojnë nëpër Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit. Marrëveshja është thënë të jetë rezultat i diskutimeve për disa muaj në mes të Komunës së Deçanit dhe përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në Manastirin e Deçanit

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

DEÇAN, 12 NËNTOR - Me ndërmjetësimin e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe me mbështetjen e ambasadorit të Italisë, Nicola Orlando e të komandantit të KFOR-it, gjeneral Michele Risi, u arrit marrëveshja për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e rrugëve të cilat kalojnë nëpër Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit. "Kjo marrëveshje është rezultat i diskutimeve disamujore, por konstruktive dhe frytdhënëse, midis Komunës së Deçanit dhe përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në Manastirin e Deçanit", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, mekanizimi i përhershëm i implementimit dhe mbikëqyrjes (Këshilli i Implementimit dhe Mbikëqyrjes), mbështetur në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (nr. 03/L-039), ka

miratuar termet e kësaj marrëveshjeje dhe kështu u është dhënë drita e gjelbër veprimeve për implementim. "Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, ka qenë i përkushtuar qysh në fillim që të ndihmojë për gjetjen e zgjidhjes sa më të mirë dhe të pranueshme, e cila ndihmon lëvizjen e lirë të qytetarëve, si liri e garantuar, por edhe ta respektojë dhe ta mbrojë trashëgiminë religjioze dhe kulturore të asaj zone. Me arritjen e kësaj marrëveshjeje dëshmohej se Republika e Kosovës është vend i të barabartëve, liritë dhe të drejtat e të cilëve respektohen dhe mbrohen njësoj", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka thënë, në një komunikatë, se marrëveshja përfshin zhvillimin e një rruge ndërkombëtare në kufijtë e Zonës së Veçantë të Mbrojtur dhe një rruge brenda kësaj zone. Sipas BE-së, "kjo marrëveshje synon t'i nxisë



marrëdhëniet mes komuniteteve përmes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe rritjes së zhvillimit ekonomik brenda Komunës së Deçanit dhe rajonit".

Arritjen e kësaj marrëveshjeje e ka komentuar edhe kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ai ka konsideruar se bllokada e deritashme për ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë ka qenë e paqëndrueshme. "Mori fund bllokada e paqëndrueshme rreth ndërtimit të rrugës Deçan - Plavë. Sipas kësaj marrëveshjeje, Komuna e Deçanit do ta procedojë rehabilitimin/shtrimin e rrugës së Gushavcit dhe asaj të Manastirit, në trasetë e tyre ekzistuese, si rrugë lokale,

duke e përfshirë këtu edhe transportin e mallrave dhe të kafshëve si nevoja të banorëve dhe familjeve që shfrytëzojnë bjeshkët përgjatë Grykës së Deçanit", ka thënë Ramosaj. Ai ka theksuar se me të njëjtën dinamikë të sinkronizuar do të rehabilitohet edhe rruga e bypassit. "Duke i dhënë fund një bllokade të paqenë të refuzimit të paarsyeshëm të ndërtimit të rrugës, hapjen e perspektivës ekonomike lokale, realizimit të lirisë së lëvizjes për banorët e Deçanit veçanërisht, dhe lidhjes ndërkombëtare ndësh-tetërore me Plavën", ka thënë Ramosaj. Në gusht të këtij viti autoritetet në Kosovë janë pajtuar që t'i pezullojnë punimet në rrugën R108, e cila përshkon një pjesë të zonës së

mbrojtur pranë Manastirit të Deçanit.

Pezullimin e punimeve e patën kërkuar edhe autoritetet në Serbi.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2016 kishte marrë vendim, sipas të cilit, Manastiri të Deçanit i njihet e drejta e pronësisë për 24 hektarë tokë. Por, ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e kësaj komune.

Zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë vazhdimisht kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në vitin 2008 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Zona të Veçanta të Mbrojtura, i cili duhet ta sigurojë mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb si dhe për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës.

Manastiri i Deçanit është një nga zonat e mbrojtura, sipas këtij ligji. Sipas ligjit, në këto zona janë të ndaluara aktivitetet e ndryshme, si: ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite në zonat rurale; dhe ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

## Vjosa Osmani: Pres që BE-ja dhe NATO-ja t'i përgjigjen kërcënimit të Vuçiqit

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pret që komuniteti ndërkombëtar të reagojë ndaj "kërcënimit" të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për "luftë të dhunshme".

Vuçiqi ka thënë të enjten se një konflikt i llojit të Nagorno Karabakut mund të ndodhë në Kosovë, nëse përpjekjet për kompromis dështojnë. Ai ka theksuar se zgjidhja më e mirë e mundshme është përmes dialogut, "në të kundërtën mund të na ndodhë ndonjë konflikt". "Unë pres që Bashkimi Evropian dhe NATO-ja t'i përgjigjen këtij kërcënimi për luftë të dhunshme, të bërë nga Vuçiqi", ka shkruar Osmani në



"Twitter".

Ndërkaq kryediplomatja e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, e ka quajtur Aleksandër Vuçiqin "këlysh të Ruisë" i cili, sipas saj, bashkë me Moskën zyrtare po tenton ta minojë

stabilitetin dhe paqenë në rajon. "Pasi furnizoi me armë konfliktin Nagorno-Karabak, me armë të prodhuara nga Serbia, Aleksandër Vuçiqi, ministër i Informacionit në kohën e Millosheviqit, tani po kërcënon

të gjithë NATO-n, si dhe po nxit vendet fqinje për përgatitje ushtarake për luftëra të reja në Ballkan", ka shkruar Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në "Twitter", duke e quajtur Vuçiqin edhe "këlysh" të Ruisë. "Politika dhe qasja e 'këlyshit të Ruisë' është qartazi kundër vlerave të BE-së dhe politikave të sigurisë së Ballkanit. Të gjitha përpjekjet ruse dhe serbe për t'i minuar paqen, stabilitetin dhe sigurinë e rajonit janë të papranueshme për Kosovën dhe, me siguri, do të dështojnë, njësoj sikurse kapitullimi i tyre famëkeq më 1999", ka shkruar ajo.

Nagorno Karabaku njihet ndërkombëtarisht si pjesë e Azerbajxhanit, por qeveriset nga armenët etnikë, me mbështetjen e qeverisë armene.

Luftimet për kontrollin e këtij rajoni kanë shpërthyer qysh më 27 shtator, ndonëse këtë javë është shpallur një marrëveshje për armëpushim.

Një luftë midis Azerbajxhanit dhe Armenisë për këtë rajon ka përfunduar në vitin 1994 me armëpushim, por pa marrëveshje të paqes. "Konflikti në Nagorno Karabak ka treguar shembullin e një konflikti të ngrirë, por kur dikush e shkrin atë, mund të përshkallëzojë në një katastrofë të vërtetë", ka pohuar të enjten Vuçiq. Kosova dhe Serbia janë në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Negociatat ndërmjetësohen nga Bashkimi Evropian dhe mbështeten nga Shtetet e Bashkuara.

QEVERIA E KOSOVËS KA BËRË PUBLIKE MASAT E REJA KUNDËR PËRHAPJES SË PANDEMISË COVID-19

# QEVERIA PËRPIQET TA FRENOJË COVIDIT, SOT ZBATOHEN MASAT E REJA ANTI-COVID



Sot (e premte), me fillim nga ora 18:00, fillon zbatimi i masave të reja për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Masat e reja ndahen në tri zona të rrezikshmërisë, sipas numrit të të infektuarve nëpër komuna: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët. Në komunat me rrezik të lartë të përhapjes së infeksionit ndalohet lëvizja e qytetarëve jashtë shtëpive të tyre pas orës 19:00 e deri në orën 5:00. Masa strikte parashihen edhe për komunat që janë në zonën e portokalltë dhe në zonën e gjelbër

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 12 NËNTOR** - Qeveria e Kosovës të enjten ka marrë vendim për masa të reja për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Masat e marra për mbrojtjen nga pandemia Covid-19, që janë vendosur në mbledhjen elektronike të qeverisë, përfshijnë masat për tërë territorin e Republikës së Kosovës, masat specifike sipas komunave dhe obligimet që marrin institucionet e caktuara për zbatimin e këtyre masave. Masat që do të hyjnë në fuqi të premtën nga ora 18:00 ndahen në tri zona të rrezikshmërisë, sipas numrit të të infektuarve

nëpër komuna: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët.

Në komunat me rrezik të lartë të përhapjes së infeksionit (mbi 150 persona të infektuar për 100 000 banorë brenda javës, ndalohet lëvizja e qytetarëve jashtë shtëpive/banesave të tyre pas orës 19:00 e deri në orën 05:00, përveç për nevoja emergjente dhe shëndetësore, duke përjashtuar nga kjo masë personelin shëndetësor, të sigurisë, drejtësisë dhe të ngjashme).

Ndalohen hyrje-daljet e

qytetarëve dhe automjeteve në territorin e komunës përkatëse nga ora 19:00 deri në orën 5:00, përveç: personelit shëndetësor, personelit të sigurisë, drejtësisë dhe studentëve.

Gjithashtu, ndalohet veprimtaria e gastronomisë nga ora 19:00 deri në orën 5:00; institucionet publike dhe private punojnë vetëm me stafin esencial, i cili staf përcaktohet me vendim të secilit institucion në veçanti; transporti publik lejohet të punojë me 50 për qind të kapaciteteve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19".

Në komunat me rrezik të mesëm të përhapjes së infeksionit (prej

76 deri në 150 persona të infektuar për 100 000 banorë brenda javës), operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 18:00, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19".

Shërbimet e hotelerisë dhe të gastronomisë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 18:00, ndërkaq pas orës 18:00 punojnë me shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë".

Të gjitha institucionet publike dhe private reduktojnë stafin e tyre bazuar në specifikat që kanë dhe duke marrë parasysh udhëzimet e specifikuara për organizimin e punës në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19". Transporti publik në këto komuna do të lejohet të punojë me 50 për qind të kapaciteteve.

Ndërsa në komunat me rrezik të ulët të përhapjes së infeksionit (deri në 75 persona të infektuar për 100 000 banorë brenda javës), operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e

Covid-19".

Transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri në 50 për qind të kapaciteteve, kurse taksitë lejohen të punojnë me një pasagjer prapa ose deri në tre nëse janë anëtarë të familjes.

Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00, veprimtaria e hotelerisë dhe gastronomisë ndalohet pas orës 20:00, përveç shërbimit "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë". Gjithashtu, lejohen pjesërisht aktivitetet kulturore të institucioneve vartëse të MKRS-së dhe të komunave (teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), duke shfrytëzuar vetëm 30 për qind të hapësirës.

**Obligimet e institucioneve për zbatimin e masave**

Masat e reja anti-Covid të qeverisë përfshijnë edhe obligimet që marrin institucionet për zbatimin e

këtyre masave. Sipas vendimit të qeverisë, obligohet Ministria e Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, të nxjerrë vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK-së. Po ashtu, obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse ta mbikëqyrin zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera për zbatimin e Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen t'i shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së

Kosovës. Ky vendim do të vlerësohet pas dy jave, varësisht nga situata epidemiologjike në vend, dhe vlen deri në një vendim tjetër.

### Tetë të vdekur dhe 767 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur tetë persona si pasojë e Covidit dhe janë paraqitur 767 raste të reja. "Janë testuar gjithsej 2 178 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 767 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 8 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren 4 raste (87, 84, 61 dhe 60 vjeç), Gjilan 2

raste (89, 77 vjeç), Prishtinë 1 rast (74 vjeç), Suharekë 1 rast (70 vjeç).", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas institutit, gjatë kësaj kohe janë shëruar 186 pacientë. "Numri total i rasteve pozitive është 26 888 raste nga 113 738 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 784 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 186 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 16 685 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 9 418", ka njoftuar instituti. Prishtina vazhdon të jetë komuna me numrin më të madh të të infektuarve. "Rastet pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 434 raste, Gjilan 58 raste, Mitrovicë 41 raste, Gjakovë 33 raste, Ferizaj 31 raste, Fushë-Kosovë 29 raste, Lipjan 16 raste, Viti 14 raste, Vushtrri 13 raste, Skenderaj 12 raste, Kamenicë 11 raste,

## Ahmeti masat e reja i quan të palogjikshme

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka reaguar sërish pas masave kufizuese që i ka marrë qeveria kundër përhapjes së Covid-19. Ai ka thënë se si pasojë e këtyre masave, më të hapur janë kufijtë e jashtëm se ata të brendshëm. "Ja edhe një absurditet: Në qoftë se je nga Kaçaniku, mundeni të shkoni në Shkup por jo në Prishtinë (pas orës 19:00). Kufijtë e jashtëm më të hapur se 'kufijtë' e brendshëm.

Maqedonia dhe ka pasur 1.318 raste me Covid!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook". Pak orë më vonë ai ka gjetur edhe masja të tjera jologjike. "Qe edhe një: Në qytetet në zonën e verdhë gastronomia mund të punojë deri në orën 18:00, e në qytetet në zonën e kuqe mund të punojë deri në orën 19:00. Kishe zona e kuqe është ajo e rrezikut të lartë! Masat pa logjikë", ka shkruar Ahmeti.

Podujevë 11 raste, Rahovec 11 raste, Prizren 9 raste, Obiliq 8 raste, Suharekë 7 raste, Drenas 5 raste, Kaçanik 5 raste, Deçan 4 raste, Pejë 4 raste, Shtime 4

raste, Dragash 2 raste, Klinë 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Istog dhe Novobërdë", ka vlerësuar IKShPK-ja.



## Hoti: Kjo është gjendje lufte


Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar të enjten Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Pas vizitës, kryeministri në oborrin e saj ka folur para mediave për gjendjen e Covidit në Kosovë. Hoti ka thënë se janë informuar për punën që po bëhet për t'u përballur me këtë situatë. "Sot u informuam për aktivitetet që po ndërmerren në përballje me këtë situatë. Kjo është situatë praktikisht e luftës, duke u përballur çdo ditë me një rrezik të madh. Shfrytëzoj rastin, me gjithë nevojën që kemi, për ta rritur efikasitetin në punë, për ta përmirësuar shërbimin, nevojën që kemi për të pasur

furnizim me barna", ka thënë Hoti, duke shtuar se në përballje me valën e dytë duhet të rritet niveli i angazhimit. "Numri i rasteve fatale së paku dhe s'ka qenë shumë i lartë. Në krahasim me rajonin, po menaxhohet pak më mirë. Do të bëjmë gjithçka që t'u qëndrojmë afër dhe t'i plotësojmë të gjitha kërkesat", ka deklaruar ai. Ndërkaq zëvendëskryeministri Besnik Tahiri ka takuar të enjten përfaqësuesit e bizneseve, të cilëve u ka thënë se janë duke i trajtuar me seriozitet kërkesat e tyre. Tahiri ka thënë se i ka dëgjuar me kujdes kërkesat e tyre dhe ka pranuar se gjendja në ekonomi nuk është e mirë.

## Federata e Sindikatave e Shëndetësisë, kryetarëve të komunave: Kini parasysh situatën e rënduar me Covid

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës (FSSHK) u ka bërë thirrje kryetarëve të komunave dhe asambleve komunale, që ta kenë parasysh situatën e rënduar me pandeminë Covid-19 kur bëjnë plane për shpenzime për t'i dekoruar qytetet për festat e fundvitit. "FSSHK-ja është njoftuar me shumata e projektuarara për një aktivitet të tillë, andaj kërkon që këto mjete të investohen në sektorin e shëndetësisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore gjatë pandemisë Covid-19 dhe për mbrojtje të popullatës në nivel të komunave. Është i patoleruar dekorimi i qyteteve për festa të fundvitit kur qytetarët tanë po ballafaqohen me kushte të

rënda mbijetese me pandeminë dhe gjendjen socio-ekonomike të familjeve të tyre", është bërë me dije në komunikatën e FSSHK-së. Kjo sindikatë u ka bërë thirrje kryetarëve të komunave dhe asambleve komunale që të jenë më të arsyeshëm sa iu përket shpenzimeve të parasë publike. "Tekefundit, Kosova që nga nesër futet pothuajse në karantinë e që nënkupton edhe kufizimin e lëvizjes së qytetarëve, andaj pyetja është kjo: Kush do t'i vizitojë këto qendra të dekoruara të qyteteve kur kemi masa kufizuese dhe të paktën a kemi ndjeshmëri dhe solidaritet këtë vit me familjet të cilët kanë humbur më të dashurit e tyre nga Covid-19?", është theksuar në komunikatën e FSSHK-së.



# FSK-ja ndihmon komunat për përballje me pandeminë Covid-19

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Në kazermën "Adem Jashari", respektivisht në Qendrën Mjekësore të FSK-së, të enjten u mbajt ceremonia e pranimit të donacionit nga Republika Federale e Gjermanisë me materiale mjekësore për përballimin e krizës të pandemisë Covid-19.

Në emër të shtetit dhurues, donacionin e dorëzoi drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneralbrigade Frank Best, kurse në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, donacionin e pranoi zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, në shoqërim të drejtorit të Qendrës Mjekësore të FSK-së, dr. Shkëlzen Sylja.

Më pas, bazuar në planin paraprak të QKMF-së, me urdhër të komandantit të FSK-së, gjeneralletjtenant Rrahman Rama si dhe në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me stafin

e lartë ushtarak gjerman, filloi operacioni i shpërndarjes së materialeve të donacionit përkatës në komunat e planifikuara të banuara nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Kontingjenti i parë i donacionit përkatës iu dorëzua Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, ku të pranishëm ishin edhe gjeneral Cikaqi, gjeneral Best dhe dr. Sylja, të cilët janë pritur nga zëvendëskryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, me bashkëpunëtorë, si dhe stafi drejtues i Qendrës Mjekësore përkatëse. Mujka në emër të stafit të QKMF-së dhe qytetarëve të komunës së tij shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e madh për FSK-në dhe shtetin gjerman për ndihmën e ofruar dhe shumë të nevojshme në këtë periudhë.

Nga ana e tyre, gjeneral Cikaqi dhe dr. Sylja i njoftuan të pranishmit me përmbajtjen e projektit dhe shprehën zotimin për vazhdimin e aktiviteteve të FSK-së me të gjitha aftësitë dhe kapacitetet operacionale në



dispozicion për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë në përballje me krizën e pandemisë Covid-19 dhe nevoja të tjera.

Shpërndarja e materialeve mjekësore përkatëse do të vazhdojë edhe gjatë pesë ditëve të ardhshme në komunat: Viti, Hani i Elezit, Kaçanik,

Mamushë, Dragash, Suharekë, Obiliq, Vushtrri, Kamenicë, Shtërpcë, Drenas, Lipjan, Fushë-Kosovë, Junik, Deçan, Skenderaj, Istog, Vitomiricë dhe Podujevë.

## Kërkohet qasje e re ndaj migrantëve

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme u mbajt të enjten takimi i radhës i grupit ndër-institucional për zbatimin e Strategjisë për Migrim, i udhëhequr nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Yildiray Bayram, njëherësh koordinator nacional për migrim. Me këtë rast, zëvendësministri Bayram i ka falënderuar të pranishmit për

pjesëmarrje, duke vënë në dukje angazhimet që janë dukje u bërë për menaxhimin e migrimin, kapacitetet që janë në dispozicion, si dhe sfidat që kanë dalë së fundi, duke përfshirë incidentet e shkaktuara nga një pjesë e migrantëve në qendrat e azilit. Zëvendësministri Bayram ka theksuar se për institucionet e Kosovës është bërë shqetësim i madh sjellja e një pjesë të migrantëve, duke u përfshirë incidentet që janë duke i shkaktuar në vendbanime të

ndryshme, me theks të veçantë sidomos te rastet si zjarrvënie të njërit nga objektet e azilit në Vranidoll dhe xhamisë në Magure, plaçkitjet në makete, dyqane, sjelljet asociale në rrugë etj. Ai ka theksuar se mekanizmat institucionalë, sidomos organet e rendit dhe të ligjit, duhet të kenë një qasje të re ndaj këtyre migrantëve që janë shndërruar në shqetësim për qytetarët.

Në këtë takim u diskutua edhe për sistemin e migrimin të Kosovës, ku u konstatua se

sistemi i migrimin, duke përfshirë legjislacionin, është i vendosur dhe është i rregulluar dhe, po ashtu, me shtetet fqinje ka një bashkëpunim të mirë kur bëhet fjalë për migrimin e parregullt. Po ashtu, u diskutua edhe për kapacitetet që ka në dispozicion Kosova, për akomodimin e migrantëve, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe për planin e veprimin për menaxhimin e fluksit të mundshëm.

Përfaqësuesit e policisë prezantuan veprimet e

ndërmarra nga takimi i fundit në lidhje me parandalimin e incidenteve që përfshijnë: Autorizimin e zyrtarëve kompetentë policorë, ku fokus do ta kenë monitorimin e migrantëve që frekuentojnë afër shkollave dhe vendbanimeve të tjera me prani të migrantëve.

Në fund zëvendësministri Bayram ka falënderuar organizatat: UNHCR, IOM, EXBS-i dhe ICITAP për përkushtimin dhe angazhimin e tyre për tejkalimin e sfidave në fushën e migrimin.



## Ngrihet aktakuza e tretë lidhur me vrasjen e Oliver Ivanoviçit

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Prokuroria Speciale në Prishtinë ka ngritur aktakuzë të re kundër të dyshuarve për ndihmë për kryerjen e vrasjes së politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanoviç, kanë konfirmuar avokatët mbrojtës, Dejan Vasiq dhe Faruk

Korenica. "Kjo është aktakuza e tretë e ngritur në këtë rast dhe të tria aktakuzat janë pothuajse të njëjta, me disa korrigjime shumë të vogla, të cilat në thelb nuk janë të rëndësishme për çështjen. Kjo është e njëjta aktakuza ndaj personave të njëjtë, për të njëjtën ngjarje.

Plotësisht e njëjtë", ka thënë avokati Dejan Vasiq për "Radion Evropa e Lirë". Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën e parë më 2 dhjetor 2019 dhe vetëm një seancë përgatitore u mbajt më 11 shkurt të këtij viti. Seanca ishte caktuar paraprakisht për 30

dhjetor, por u anulua sepse prokurori i atëhershëm, Sylë Hoxha, paraqiti një aktakuzë të re, të ndryshuar.

Oliver Ivanoviç më 16 janar 2018 është vrarë me gjashtë të shtëna në shpinë para objektit të partisë së tij Liria, Demokracia, Drejtësia në

Mitrovicën e Veriut. Nga përfundimi i luftës në Kosovë ai ka qenë ndër politikanët më të rëndësishëm, ndërkohë që për disa vite rresht është përballur me një proces gjyqësor nën akuzat për "rolin e tij" në vrasjen e shqiptarëve në luftën e viteve 1998-'99.

# Shqiptohen 25 gjoba mandatore për ndotësit e mjedisit gjatë muajve shtator-tetor

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 NËNTOR - "Let's Do It" Kosova vazhdon monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Ndëshkime me Gjoba Mandatore si dhe të Rregulloreve Komunale për Mjedis.

Të dhënat e marra nga secila komunë në Republikën e Kosovës për numrin e gjobave mandatore që janë shqiptuar gjatë muajve shtator-tetor 2020, janë si vijon: Institucionet përkatëse në gjithë Republikën e Kosovës gjatë muajve shtator-tetor, sipas Udhëzimit Administrativ për Ndëshkime me Gjoba Mandatore, kanë shqiptuar gjithsej 25 gjoba për ndotësit e mjedisit. Gjobat u shqiptuan nga këto komuna: Malishevë (5), Istog (5), Drenas (4), Klinë (4), Rahovec (3), Kamenicë (3), Deçan (1). Komuna e Gjilanit ka dërguar raport vjetor nga janari deri në tetor, ku janë shqiptuar gjithsej 15 gjoba mandatore. Komunitat të cilat nuk shqiptuar

asnjë gjobë mandatore gjatë muajve shtator dhe tetor janë: Komuna e Skenderajt, Lipjanit, Obiliqit, Podujevës, Mitrovicës, Hanit të Elezit, Junikut, Shtimes, Kaçanikut, Gjakovës.

Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka shqiptuar asnjë gjobë. Inspektorët nga kjo komunë kanë raportuar për mungesën e bashkëpunimit të qytetarëve gjatë vërejtjeve verbale që janë dhënë në rastet e ndotjes së ambientit (qytetarët kanë refuzuar të japin të dhëna personale pa të cilat nuk mund të shqiptohet dënimi). Po ashtu, për shkak të situatës me pandeminë, ata nuk janë asistuar as nga Policia e Kosovës. Kurse nga komunat Prishtinë, Vushtrri, Ferizaj, Prizren, Pejë, Suharekë nuk kemi marrë asnjë raport.

"Let's Do It" ka njoftuar se monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore do të vazhdojë edhe gjatë muajve në vijim, kur edhe do të bëhen publike të gjitha të dhënat. "Për shkak të pandemisë Covid-19 kishte



shumë pak gjoba të shqiptuara gjatë muajve shtator dhe tetor, por duke shpresuar në normalizim të situatës dhe në

ndërgjegjen institucionale, besojmë se gjatë muajve në vijim gjobat mandatore do të gjejnë zbatim në vendin tonë dhe, mbi

të gjitha, qytetarët do të jenë më të vetëdijshëm për dëmet që i shkaktojnë mjedisit nga ndotja", njoftuar "Let's Do It".

## Kosova dhe Italia arrijnë marrëveshje për bashkëpunim policor



Prishtinë, 12 nëntor (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme po qëndron për vizite zyrtare në Republikën Italiane. Ai të enjten së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Luciana Lamorgese, kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim policor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë.

Në njoftimin për media të Ministrisë së Punëve të Brendshme theksohet se kjo marrëveshje edhe më tutje do t'i forcojë përpjekjet e përbashkëta

të dy vendeve për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit transnacional, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Me këtë rast, ministri Veliu ka vlerësuar lart bashkëpunimin me strukturat e ndryshme të sigurisë së Republikës italiane, duke shprehur përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të qenë një aleate dhe partnere e besueshme.

Në njoftim theksohet se ministri Veliu ka falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme që

Republika italiane ka dhënë për shtetndërtimin e Republikës së Kosovës dhe për mbështetjen në proceset integruese euroatlantike.

Ndërsa ministrja e Brendshme e Republikës së Italisë, Luciana Lamorgese, vlerësoi lart bashkëpunimin me Republikën e Kosovës në fushën e sigurisë dhe shprehu gatishmërinë për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit në çështjet me interes të përbashkët, për sigurinë rajonale dhe atë evropiane.

## Tërhiqet shorti për renditjen e kandidatëve për kryetar në fletëvotimin e zgjedhjeve në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka organizuar ceremoninë e tërheqjes së shortit për renditjen e kandidatëve dhe të subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, të cilat do të mbahen më 29 nëntor 2020. Kandidati i Lëvizjes

Vetëvendosje, Erden Atiq, mban numrin 121; kandidati i pavarur, Dushan Milunović, numrin 122; kandidati i Listës Serbe, Milan Radojević, numrin 123; dhe kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës, Florent Azemi, numrin 124.

Ndërkaq në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës, më 20 shkurt 2020, Komisioni Qendror

i Zgjedhjeve ka marrë vendim për certifikimin e tre kandidatëve si dhe më 2 mars është tërhequr shorti për renditjen e tyre në fletëvotim. Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës, Naim Fetahu, mban numrin 10; kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Nexhmi Rudari, numrin 11; dhe kandidati Lëvizja Vetëvendosje, Shpejtim Bulliqi, numrin 12.



# Finalizohet plani për përmirësimin e integritetit të ATK-së

Prishtinë, 12 nëntor (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka finalizuar hartimin e planit për përmirësim të integritetit, i cili në fund të vitit 2019 kishte nisur të hartohet në bashkëpunim me programin e USAID-it për qeverisjen ekonomike në Kosovë. Ky plan ka për qëllim t'i identifikojë fushat që kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ambicet e menaxhmentit për përmirësimin e efikasitetit dhe të integritetit të ATK-së. Administrata Tatimore e Kosovës gjatë hartimit të planit për përmirësim të integritetit të saj ka zhvilluar konsultime publike me bizneset, odat ekonomike, shoqatat, shoqërinë civile, mediat, donatorët dhe institucionet

publike. Tryezat konsultative ishin të rëndësishme për ndërtimin e dialogut të strukturuar të parë të këtij lloji për ta inkurajuar kontributin publik për ta përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e ATK-së. Nga të gjitha takimet e mbajtura, rreth 100 pjesëmarrës kanë dhënë rekomandimet e tyre lidhur me pritshmëritë për integritetin e ATK-së. Përmirësimi i integritetit të ATK-së përmes këtij plani është i fokusuar në përdorimin e të dhënave objektive për matjen e performancës së menaxhimit të brendshëm, komunikimin me publikun dhe tatimpaguesit, si dhe prezantimin e shërbimeve elektronike shtesë për qytetarët që aktualisht kërkojnë vizita



fizike në zyrat e ATK-së. Po ashtu, ky plan do të ndihmojë në përmirësimin e strukturave të brendshme, proceseve, politikave dhe procedurave të

burimeve njerëzore për nxjerrjen në pah të çështjeve potenciale të integritetit të punës së stafit të ATK-së. ATK-ja pret që nga implementimi

i këtij plani ta rrisë transparencën dhe llogaridhënien, të cilat më pas do ta rrisin edhe më shumë besimin dhe perceptimin e publikut ndaj saj.

## Bordi i Rregullatorit për Energji miraton disa kërkesa të KOSST-it

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Bordi i Rregullatorit për Energji ka mbajtur mbledhjen e nëntë me radhë për këtë vit. Në këtë mbledhje janë miratuar kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSST) lidhur me procedurat për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese Kosovë - Shqipëri dhe alokim të kapaciteteve interkonektive, si dhe rregullat e ankandit për alokimin e kapaciteteve në Zyrën e Ankandit të koordinuar në Evropën Juglindore. Në këtë mbledhje bordi ka miratuar licencat afatgjata për prodhim të energjisë elektrike të ndërmarrjes "Kelkos Energy Sh. P. K" për "HC Deçani" dhe "HC Belaja". Pjesë e shqyrtimit



dhe miratimit të bordit në këtë mbledhje ishte edhe aneksi i marrëveshjes KEK Termokos lidhur me çmimin e energjisë elektrike nga ko-gjenerimi. Bordi, po ashtu, ka miratuar

kërkesat e tetë aplikuesve për ndërtimin e gjithsej 233 kW kapacitete gjeneruese për vetëkonsum nga panelet solare në Komunën e Prishtinës, Garaçanicës, Malishevës dhe

Deçanit. "Bordi ka shqyrtuar planin e performancës së Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2021. Ky plan i performancës është një faktor i rëndësishëm përcaktues për

përbushjen e detyrave dhe përgjegjësi ligjore të përcaktuara me nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë si dhe për planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve të ZRRE-së përgatitur në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084) dhe nenit 43 pika 3 e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Ligji nr. 06/-113). Si zakonisht në seancat e bordit, edhe sot janë shqyrtuar edhe disa ankesa të konsumatorëve si dhe çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit", është bërë me dije në njoftimin për media.

## OAK-u: Do të rritet numri i bizneseve të falimentuara

Prishtinë, 12 nëntor (ER) - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka shprehur keqardhje për humbjet që kanë pësuar bizneset në këtë kohë pandemie dhe për humbjet e vendeve të punës ku, si pasojë, nuk do të kenë humbje vetëm bizneset, por edhe shteti. "Kjo humbje do t'i shkaktohet shtetit përmes mungesave buxhetore që janë duke u rritur çdo ditë e më shumë. OAK-u shpreh indinjatë që Kuvendi nuk është në gjendje të realizojë një veprim të vetëm, e i cili është

kalimi i Pakos së Rimëkëmbje Ekonomike, duke kërkuar edhe një herë që në këtë pako të merren parasysh kërkesat e bizneseve. Kjo tregon një joseriozitet të lartë të paraqitur në të gjitha instancat shtetërore sa i përket vendimit të fundit të marrë nga Qeveria e Kosovës për mbyllje të ekonomisë", është thënë në reagimin e OAK-ut. OAK-u ka vlerësuar se duke u bazuar në të dhënat e vazhdueshme që marrin nga bizneset dhe gjendjen e rëndë

në të cilën është biznesi, duke vazhduar t'i mbajë jashtë mundësi punëtorët, konsideron se këto masa do ta dëmtojnë shumë rëndë biznesin dhe numri i bizneseve të falimentuara do të rritet së bashku me numrin e qytetarëve të papunë. "OAK-u vlerëson që vendimet e tilla mund të merren vetëm pasi Qeveria e Kosovës t'i përkrahë bizneset dhe punëtorët për kohën sa këta qytetarë do të jenë të papunë", ka bërë me dije Oda e Afarizmit e Kosovës.



# BQK-ja parasheh rënie ekonomike 7.2 për qind

Për shkak të masave izoluese dhe kufizuese, me tentim të ndalimit të përhapjes së Covid-19 dhe mosardhjes së diasporës këtë verë, ekonomia e Kosovës do të pësojë rënie 7.2 për qind ka thënë të enjten, në një konferencë për media, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti. Ai ka thënë se çdo ditë vonesë për miratimin e Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike ka pasoja të mëdha



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Drejtuesit e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) kanë theksuar se janë duke i përcjellë me vëmendje zhvillimet lidhur me pandeminë në vend. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, në një konferencë për media të enjten, ka theksuar se sektori bankar është stabil, likuid dhe me afarizëm pozitiv. Mehmeti ka thënë se Kosova do të ketë rënie ekonomike prej 7.2-përqindësh në vitin 2020. Guvernatori ka pohuar se shkaktarët mbrapa rënies ekonomike kryesisht lidhen me masat e ndërmarra

për pengimin e shpërndarjes së pandemisë, të cilat ndikuan negativisht edhe në nivelin e konsumit, edhe në nivelin e investimeve në vend. "Parashikimet e BQK-së janë që ekonomia e Kosovës për vitin 2020 do të shënojë rënie prej 7.2-përqindësh. Shkaktarët lidhen me masat e ndërmarra që ndikuan negativisht në nivelin e investimeve. Një prej faktorëve që ka ndikuar në uljen e kërkesave agregate është rënia e vizitave nga diaspora", ka deklaruar Mehmeti.

Ai ka thënë se dërgesat nga diaspora këtë vit kanë shënuar rritje. "643 milionë janë në këtë vit, kurse në vitin e kaluar

remitancat kanë qenë 608.6 milionë euro", u shpreh Mehmeti. Ai nuk ka komentuar çështjen e dymilionëshit që ka ndodhur në Thesarin e Shtetit, duke thënë se kjo është punë e ministrisë. Mehmeti përsëriti edhe një herë rëndësinë që e ka miratimi sa më i shpejtë i Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike në Kuvendin e Kosovës, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e

konsiderueshme e pakos së rimëkëmbjes ekonomike bazohet në masat për lehtësimin e qasjes në financa. Ai ka shtuar se vlera e kredive aktive në sektorin bankar të Kosovës në shtator 2020 ishte 3.2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6-përqindësh. "Vlera e kredive të reja të lëshuara për periudhën janar-gusht 2020 është 912.5 milionë euro, krahasuar me 959

milionë euro apo rënie prej 5-përqindësh, krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, gjatë muajve korrik-gusht të këtij viti kemi të dhëna premtuese, ku kreditë e reja të lejuara nga sektori bankar janë në vlerë prej 320.7 milionë eurosh krahasuar me kreditë e reja të lëshuara në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 260 milionësh, apo një rritje prej 23-përqindësh", ka thënë Mehmeti.

## 'Trepça' kërkon ndihmë financiare nga qeveria

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Blerim Kuçi, bashkë me drejtorin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Besnik Krasniqi, kanë pritur në takim Këshillin Grevist të Punëtorëve të "Trepçës", i kryesuar nga Ragip Istrefi, përfaqësuesin e Sindikatës së "Trepçës", Gani Osmani, ushtruesin e detyrës së kryeshefit të "Trepçës", Hysen Vrajolli dhe disa punëtorë të ndërmarrjes. Temë diskutimi në këtë takim ishte gjendja e vështirësuar e ndërmarrjes publike "Trepça", gjegjësisht



bllokimi i llogarive të tyre, duke pamundësuar edhe dhënie e pagave. Ministrin Kuçi i janë paraqitur

kërkesat e Këshillit Grevist, i cili ka kërkuar ndihmë financiare. Duke u treguar për ndihmën që kësaj ndërmarrje i është dhënë

edhe me masat përkrahëse të pakos për rimëkëmbje ekonomike, ministri Kuçi u ka premtuar punëtorëve dhe

menaxhmentit që nga buxheti për rimëkëmbje ekonomike brenda Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike do t'u ndahet një shumë e mjeteve dhe do të kërkohej në mbledhje të qeverisë ndihmë shtesë. "Ajo që mund t'ju garantojë është se ne kemi një shumë të mjeteve në buxhetin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, të cilën mund ta ekzekutojmë menjëherë. Mirëpo, kërkesa juaj është më e madhe dhe për këtë unë në mbledhje e nesërme të qeverisë do ta paraqes këtë shqetësim dhe do të kërkoj ndihmë për juve për të kaluar këtë situatë", ka thënë ministri Kuçi.

## Klubi i Prodhuesve të Kosovës organizon edicionin e pestë të Green Business Expo

Prishtinë, 12 nëntor (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës organizon edicionin e 5-të të Green Business Expo, i cili këtë radhë do të jetë virtual. Në njoftimin për media bëhet me dije se ky edicion do të jetë i disponueshëm në gjuhën shqipe dhe angleze dhe do të vijë me një koncept të ri dhe në nivel me panairt virtuale

ndërkombëtare, ku pjesëmarrës do të jenë kompani nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Sektorët të cilët do të jenë pjesë në këtë edicion janë: ndërtimi dhe eco-enterieri, eficientia e energjisë, energjia e ripërtërishme dhe riciklimi.

"Ky panair për pesë vjet radhazi është një ndër aktivitetet më të rëndësishme për bizneset e gjelbra në Kosovë dhe ofron një platformë të rrjetëzimit të këtyre bizneseve, institucioneve qeveritare, donatorëve dhe të gjithë aktorëve relevantë", thuhet në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.



## KFOR-i dhe FSK-ja dhurojnë pajisje mbrojtëse për Covid-19 për Komunën e Mitrovicës

MITROVICE, 12 NËNTOR (ER) - Qendra Mjekësore e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe KFOR-i gjerman kanë dorëzuar të enjten donacionin me pajisje mbrojtëse mjekësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë. Të pranishëm me rastin e dorëzimit të këtij donacioni ishin nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, si dhe Frank Best,

gjeneralbrigade, njëkohësisht drejtor i NALT-it. Me këtë rast nënkryetari Mujka ka falënderuar përfaqësuesit e FSK-së dhe të KFOR-it për dhurimin e këtij donacioni mjaft të nevojshëm për përballimin e kësaj situate, duke thënë se ky material do ta lehtësojë punën e stafit shëndetësor në QKMF, të cilët gjenden në vijën e parë të frontit për menaxhimin e këtij virusi.

Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj

Barani, e ka vlerësuar shumë të dobishëm këtë donacion për kujdesin parësor shëndetësor, duke theksuar se Drejtorja e Shëndetësisë është e përkushtuar që së bashku me qytetarët të ruajë shëndetin publik.

Ky donacion përmban pajisje mbrojtëse mjekësore: maska të llojeve të ndryshme, doreza, rroba, mburoja për fytyrë, kapele kirurgjike, si dhe materiale të tjera përcjellëse, të gjitha bashkë në vlerë prej 10 mijë eurosh.



## Haziri dhe Damianovski: Gjilani dhe Kumanova, shembulli më i mirë i bashkëpunimit ndërkufitar

GJILAN, 12 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe ai i Kumanovës, Maksim Damianovski, pas marrëveshjes së binjakëzimit, kanë deklaruar se këto dy komuna janë shembulli më i mirë i bashkëpunimit ndërkufitar për 17 vjet.

Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, pasi falënderoi kryetarin Damianovski për bashkëpunimin, tha se në të ardhmen do t'i integrojnë edhe më shumë aktivitetet ekonomike, kulturore dhe arsimore. "Bashkëpunimi ynë ndërkufitar ka kulmuar me hapjen e vendkalimit kufitar, për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave. Komunikimi i njerëzve, familjeve, ekonomisë dhe biznesit është synimi ynë. Besojmë shumë që do ta kemi edhe mbështetjen e dy qeverive tona, Prishtinës dhe Shkupit. Besojmë shumë që mikro-regioni evropian, ku



përfshihen Presheva, Bujanoci dhe 17 komunat e tjera, do të zhvillohet shumë si shembull i mirë i bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor", ka deklaruar Haziri.

Kurse kryetari i Kumanovës, Maksim Damianovski, pasi e ka falënderuar Hazirin për bashkëpunimin 17-vjeçar, ka thënë se ky është një shembull i mirë i bashkëpunimit jo vetëm në nivel lokal, por edhe

në atë regional. "Jemi dy komuna në zonë kufitare, kemi aplikuar me një numër të madh të projekteve të përbashkëta, të cilat jemi duke i kryer. Pra, bëhet fjalë për tri projekte të përbashkëta. Njëra nga nismat kryesore të partneritetit dhe miqësisë sonë është hapja e vendkalimit kufitar që tashme është bërë realitet", ka thënë Damianovski.

## Realizohet projekti i analizave agrokimike të tokës në Podujevë

PODUJEVA, 12 NËNTOR (ER) - Në kuadër të investimeve dhe subvencionimeve në sektorin e bujqësisë, në fshatrat e Komunës së Podujevës është duke u realizuar projekti i analizës së cilësisë së tokës. Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Vezir Januzi, vizitoi fshatin Llugë, për ta përcjellë nga afër realizimin e këtij projekti, i cili u mundëson fermerëve llogaritjen e

kulturave bujqësore bazuar në specifikat dhe kualitetet e tokës së tyre.

Rekomandimet dhe analizat e tokës do t'i ndihmojnë fermerët për orientimin dhe kultivimin e duhur të kulturave në secilën tokë përkatëse, në mënyrë që edhe rendimentet të jenë sa më të larta dhe cilësore.

Në këtë fazë do të përfshihen 24 fshatra, do të merren 1 000 mostra, 70 për qind prej tyre në thellësi 30 cm dhe 30 për qind në thellësi 70 cm.



## Haskuka pret në takim ambasadorin e Hungarisë, diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit

PRIZREN, 12 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka prituri të enjten në takim ambasadorin e ri të Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin e Komunës së Prizrenit me Ambasadën e Hungarisë dhe mundësitë e

thellimit të këtij bashkëpunimi, sidomos në ekonomi dhe në arsim. Gjatë këtij takimi kryetari Haskuka dhe ambasadori Bencze po ashtu diskutuan për mundësinë e binjakëzimit të Prizrenit me qytetet e Hungarisë dhe themelimin e një konsullate nderi të

Hungarisë në Prizren. Me këtë rast, kryetari Haskuka falënderoi ambasadorin hungarez për 75 bursat e ndara nga shteti i tyre për studentët e Kosovës dhe për pajisjet mjekësore të ofruara nga qeveria hungareze në luftën kundër pandemisë.



## Jashari thërret mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Skenderaj

SKENDERAJ, 12 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thirrur për 19 nëntor mbledhjen e radhës të

Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Në këtë mbledhje do të diskutohet lidhur me gjendjen me Covid-19 në Komunën e Skenderajt,

rreth çështjes së sigurisë, punës së komiteteve lokale për siguri publike si dhe rreth përgatitjes për sezonin dimëror në këtë komunë.

# Satanizimi i UÇK-së nga Specialja



Faton MEHMETAJ

Evropa, djepi i demokracisë, shembull për barazi gjinore e racore, me shekuj luftoi për të drejtat e popujve të shtypur, është model për respektimin e të drejtave dhe lirisë njerëzore. Sa e sa shtete e kombe të reja i lindi e rriti Evropa plakë, në mesin e tyre edhe shtetin e Kosovës. Derdhi biliarda deviza për ta shkatërruar e gjuhëzuar komunizmin, e ne të parët nga popujt e tjerë u bashkuam në këtë projekt të madh, më

Evropën e projektuesit e tjerë të këtij projekti. Evropa shpenzoi biliarda deviza për ta shpërbërë Jugosllavinë, e ne ishim të parët ata që u bashkuam në këtë projekt. Kjo kishte kosto të lartë, por ne e përballuam vetë. Për ta ndaluar gjenocidin, shfarosjen masive dhe dëbimin e komplet popullatës nga trojet e veta, Evropa organizoi fushatën e NATO-s, më sa më kujtohet 72 ditë bombardime mbi caqet serbe, derisa ushtria dhe policia serbe e dhanë kapitullimin. Në këtë kohë Shtabi i NATO-s, liderët e Evropës dhe mbarë bota demokratike i kishin vënë shpresat tek ata burrat që i morët para disa ditësh. Qe nga ajo kohë UÇK-ja as më të voglin veprim nuk e ka pasur jashtë koordinimit derisa vendi është çliruar. Pasi është liruar Kosova nga okupatori serb i cili kishte

ardhur në vitin 1912 si pushtues, ruajtjen e popullatës, përgjegjësitë e sigurisë dhe të ndërtimit të shtetit i kishte marrë KFOR-i, UNMIK-u, OSBE-ja e mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë. Edhe pas mbarimit të luftës dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, UÇK-ja ka qenë partner besnik i këtyre mekanizmave. Në marrëveshje me liderët e UÇK-së u bë demobilizimi i UÇK-së dhe mobilizimi i tyre në TMK, Policinë e Kosovës e në mekanizma të tjerë të shtetndërtimit të Kosovës. Kurse pjesa tjetër e vazhduan jetën politike dhe më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës i ndihmuar edhe nga forcat progresive të vendit të prirë nga çlirimtarët e shpallën pavarësinë e Kosovës që ishte kurorëzim i një

rrugëtimi të gjatë e shumë të vështirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës që bënë mund, sakrificë e luftuan për këtë ditë. Është mirë që Evropa si djep i demokracisë t'ia tregojë UÇK-së faturën e kujt jemi duke e paguar, sepse edhe 100 vjet të tjera po ta hetoni e gjykoni UÇK-në nuk mundeni për të gjetur tek ata madje as më të voglën njollë (përdorni edhe mikroskopin për zmadhim, por prapë nuk keni për të pasur mundësi të gjeni asgjë). UÇK-ja ka qenë shembull edhe për NATO-n, edhe për ushtritë tjera të vendeve të Evropës, Ballkanit e Botës, për respektim të rregullave dhe parimeve të luftës. Krahaso ushtarët e UN-it, por edhe të tjerët, çka kanë bërë në Bosnje e vendet tjera të ish-Jugosllavisë. Është turp për Evropën në zemër të Evropës për të formuar gjyq

të tilla, kaq pa kuptim e kaq denigruese për popullin shqiptar që ka një histori 5 mijëvjeçare më civilizim e kulturë. Kjo gjykatë ka më qenë njollë e zezë që do të shlyhet shumë më vështirë, si njëra nga padrejtësitë më të mëdha, që drejtësia e vendeve të djepit ku është rritë demokracia, po bënë padrejtësi ndaj një populli që nuk e ka asnjë gabim. Gjykata Speciale është duke e nxitur popullin e Kosovës direkt për një luftë të re ndaj Serbisë, por tani duke i përdorur metodat e Serbisë që ajo ka përdorur në Kosovë, si formë e drejt dhe e përkrahshme për t'u përkrahur nga bota e qytetëruar. Gjykatën na detyruan ta formojmë, por tani na i mohoni simbolet dhe praninë shtetërore në Gjykatën Speciale. Sjelljet e tilla kanë një emër padrejtësi në emër të drejtësisë.



## Kosova duhet t'i mbushë Dhomat e Specializuara në Hagë me kallëzime penale

*Kosova duhet t'i mbushë Dhomat e Specializuara me kallëzime penale dhe Këshilli i Evropës urgjentisht duhet ta pranojë Kosovën si anëtare e saj*



Bejtush ISUFI, avokat

Prokuroritë, gjykatat dhe qytetarët e Kosovës nuk duhet të rrinë duarkryq si deri më tani. Ata duhet t'i dërgojnë Prokurorisë së Dhomave të Specializuara në Hagë të gjitha kërkesat për hetime dhe kallëzime penale ndaj

strukturave kriminale të Serbisë. Kosova është duke u përballur me një gjendje "fait accompli" që lidhet me krimet e pretenduara të Gjykatës Speciale. Tashmë aktakuzat janë ngritur. Figurat qendrore të ish-shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së janë ndaluar në selinë e gjykatës në Hagë. Ata akuzohen për krime të pretenduara luftë! Gjithë dokumentacioni inkriminues ose pjesa më e madhe, tashmë dihet që ka si adresë Serbinë. Por, çfarë kemi bërë dhe po bëjmë ne? Prokuroritë, gjykatat dhe qytetarët e Kosovës nuk duhet të rrinë duarkryq si deri më tani.

Ata duhet t'i dërgojnë Prokurorisë së Dhomave të Specializuara në Hagë të gjitha kërkesat për hetime dhe kallëzime penale ndaj strukturave kriminale të Serbisë, dhe ndaj cilitdo individ për të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Ky është mandati i kësaj gjykate. Kjo gjykatë, nuk mund ta refuzojë hetimin e asnjë krimi i cili bie brenda kompetencës lëndore territoriale dhe kohore të saj. Të gjitha institucionet, profesionistët, shoqëria civile e Kosovës dhe secili qytetar, ka obligim qytetarë dhe patriotik që të bëj kallëzimin e veprave

për të cilat ka dëshmi dhe mund të dëshmoj. Udhëheqja politike e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia dhe shtetet tjera mike, duhet të reagojnë, të insistojnë dhe të përgatisin kërkesa në Këshillin e Evropës që Republika e Kosovës të pranohet si anëtare e kësaj organizate. Kjo, me qëllim që të gjithë ata që do të jenë pjesë e ndjekjes dhe e dënimeve nga Dhomat e Specializuara në Hagë, të mund të kërkojnë drejtësi edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Me vendimin e Këshillit të Evropës, është vendosur të nisen

hetimet sipas raportit të Dick Martit e pastaj, pikërisht për shkak të këtij raporti, janë themeluar Dhomat e Specializuara. Prandaj, ky është detyrimi minimal, thjeshtë më minimal i Këshillit të Evropës ndaj qytetarëve që do të jenë subjekt i Dhomave të Specializuara. Kundërshtimi i cilitdo anëtar të kësaj organizate, do të ishte moralisht i papranueshëm, politikisht i paarsyetueshëm dhe juridikisht i parrëzueshëm. Në të kundërtën, mohimi i kësaj të drejte për Kosovën do të ishte diskreditues dhe komprometues për vet Këshillin e Evropës.



© Erwin Elsner/dpa/picture-alliance

# Të pathënat e Merkel, jeta në Poloni, ku ndodhej ku u rrëzua Muri të Berlinit

Është viti 1989. Në nëntor rrëzohet Muri i Berlinit. Angela Merkel është tridhjetë e pesë vjeçe, ka doktoruar në shkencat e natyrës. Ajo punon në Institutin Qendror të Kimisë Fizike, i cili i përket Akademisë së Shkencave të RDGJ. Shkencëtarja e re jeton në Berlin dhe sapo është divorcuar. Në krah të saj është partneri i ri, shkencëtari i kimisë kuantike Joachim Sauer, me të cilin ajo do të martohet nëntë vjet më pas. Katër ditë pas rënies së Murit të Berlinit, me ftesë të një kolegu polak, Merkel udhëtoi drejt fqinj. "Ajo erdhi me tren në Torunj. Unë e prita tek stacioni i trenit. Mbahti një referat dhe qëndroi në shtëpinë tonë. Biseduam për gjëra të ndryshme, për politikën dhe ëndrrat tona që po bëhen realitet," kujton Jacek Karwowski, profesor në pension i mekanikës kuantike në Universitetin Nicolaus Copernicus në Torunj.

## "E kam pritur tërë jetën"

Ai e ka ende divanin në të cilin ishte ulur Angela Merkel atëherë. "Po pinim çaj ose kafe dhe në televizion shfaqeshin pamje nga Muri i Berlinit, të cilin njerëzit e thyenin me çekanë. Angela shikonte me lot në sy. "Tani po

ndodh. Kam gjithë jetën që e pres dhe gjithçka po ndodh atje ndërkohë që unë jam këtu", tregon Karwowski. Vite më vonë, Merkel, tashmë kryetare e CDU, do të tregonte se si kolegët e saj polakë kishin "mbetur të shtangur", sepse ajo nuk kishte qëndruar në Gjermani, në atë kohë që gjithçka ishte aq emocionuese. "Ata më thanë se në vizitën e tyre të ardhshme në Berlin, Gjermania mund të ishte ribashkuar. Kjo më la mua pa fjalë,

gjithsesi më hapi sytë. Për ne, rënia e Murit ishte aq mbresëlënëse sa, ndryshe prej tyre, na u desh shumë kohë të kuptonin pasojat e saj", tha ajo për "Berliner Morgenpost" në 2003. Kur u rrëzua Muri më 9 nëntor 1989, Merkel ishte në saunë me një mikeshën e saj dhe më pas kishte dalë për një shëtitje në Berlinin Perëndimor. Ajo e sheh veten "në një dilemë", siç tregon në vitin 2008, kur iu dha një doktoraturë nderi nga Universiteti Teknik i

Vroclavit. Katër ditë pas Rënies së Murit, i duhet të mbajë një referat të rëndësishëm në Poloni, ndërkohë që Berlini ishte pa mur dhe ajo mund të shkonte lirisht në Perëndim. Merkel merr vendim t'i bëjë të dyja dhe merr udhën për në Poloni.

## Biseda mbi lirinë

Në vitin 1989 Merkel dhe Karwowski njihen tashmë prej

disa vitesh. Ajo që i lidh ata është shkenca, por edhe ëndrrat e përbashkëta për të cilat ata flasin gjatë takimeve të shkencëtarëve në Liqenin Bachotek. Kimistët kuantikë takohen atje rregullisht në kampe verore në Universitetin e Torunjit. Merkel ka qenë aty në vitin 1985, 1987 dhe 1989, kujton Karwowski.

Merkel ka qenë edhe në Poloni më 4 qershor 1989, kur atje u mbajtën zgjedhjet e para, pjesërisht të lira, të gjithë Bllokut Lindor që ishte nën sundimin sovjetik. "Në një farë mënyre, kjo datë shënoi një pikë kthese në biografinë time," do të thoshte Merkel më vonë.

Në Bachotek të gjithë ndihen të lirë, nuk i censurojnë fjalët e tyre. Kur nuk flasin për shkencë, diskutojnë për politikë. Më vonë Merkel thotë se ka ruajtur kujtime të bukura nga takimet. Ne nuk ishim revolucionarë, tregon Jacek Karwowski. "Për ne ishte e qartë që duhej të kishte një ndryshim të natyrshëm të sistemit," thekson ai. "Angela thoshte, se ajo nuk donte revolucion, por vetëm të kalonte kufirin lirshëm dhe të pinte një kafe në Perëndim", kujton Karwowski. "Unë nuk do të arratisem, por ata kanë vënë telat me gjemba. Për çfarë e bëjnë? Unë do të doja të kthehesha në shtëpi,



Ne foto: Angela Merkel (përpara e gjashta nga e djathta) dhe Joachim Sauer (rreshti i parë në këmbë, i shtati nga e majta) - Shkolla verore në Bachotek, Poloni

por edhe të shkoja atje ku dua ", kujton Karwowski fjalët e Angela Merkelit.

Një tjetër pjesëmarrës i kampit veror, Grzegorz Chałasiński, vëren se Merkel dhe partneri i saj Joachim Sauer e njihnin mirë lëvizjen polake Solidarno??. "Ata shpresonin që diçka e mirë do të vinte prej saj. Të gjithë donim që ky makth i RDGJ-së dhe Republikës Popullore Polake të mbaronte", kujton profesori i kimisë.

### Takimet "familjare"

Për kolegët polakë të Merkel, fillimi i viteve 1980 ishte një kohë plot shpresë. Në verën e vitit 1980 u themelua sindikata e pavarur polake Solidarno??. Në të cilën ata më vonë do të bëheshin aktivë. Që në këtë kohë Angela Merkel do të dëgjonte për Solidarno??. megjithëse udhëheqja e Gjermanisë Lindore ishte e kujdesshme që "virusi polak" të mos përhapet në RDGJ. Merkel vinte në takimet që organizonte çdo muaj ilustratori Stefan Dachsels. "Ishte e ndaluar të krijoheshin organizata, kështu që takoheshim si një rreth familjar. Gjithmonë në banesën e një anëtarit tjetër. Kështu vazhdon edhe sot," thotë Dachsels, i cili atëherë ishte aktivist në Kishën Ungjillore dhe tani është politikan i CDU. Në takime vijnë të diplomuar nga universitete dhe disiplina të ndryshme. Angela Merkel ishte gjithashtu pjesë e tyre disa herë në fillim të viteve 1980. Në "rrethin familjar" mund të diskutohet pa censurë. Flitej edhe për Solidarno??. grevat në Poloni dhe situatën e përgjithshme atje. "Ishte e rëndësishme për ne, pasi e kishim ende në kujtesë shtypjen e kryengritjes popullore në RDGJ në vitin 1953 dhe Pranverën e Pragës në 1968", thotë Dachsels. Në atë kohë askujt nuk ia merrte mendja se Solidarno?? një ditë do të luante një rol kryesor në rënien e diktaturave të vërteta socialiste.

### Incident në kufi

Ndërkohë që Solidarno?? po merrte hov, Merkel udhëtoi tri herë në Poloni në vitin 1981, kujtojnë biografët Ralf Georg Reuth dhe Günther Lachmann. Ajo udhëtonte në kuadër të Rinisë së Lirë Gjermane (FDJ). Në atë kohë, edhe ajo kishte një funksion në organizatën rinore, e cila vepronte si rezervë luftarake e Bashkimit Socialist të Gjermanisë (SED), partia sunduese në ish-RDGJ. Udhëtimi i tretë ishte privat. Së bashku me një koleg në atë kohë, ajo shkoi në Gdańsk dhe Malbork, në gjurmët e Solidarno??. por edhe të familjes. Nëna e Merkelit vjen nga kjo zonë.

"Më 12 gusht ata kthehen. Në kufirin pranë Frankfurtit mbi Oder, rojet kufitare të RDGJ-së jo vetëm që kontrolluan dokumentat e tyre, por edhe çantën e Merkelit. Aty do të gjenin dokumenta të Solidarno??-it: dy foto të memorialit të punëtorëve të vrarë në kryengritjen e vitit 1970, një revistë dhe një distinktiv",



Foto: Angela Merkel (djathtas) - Shkolla verore në Bachotek; Poloni 1989

shkruajnë biografët dhe citojnë deklarinim përkatës. "Qytetarja nuk ishte në dijeni se sende të tilla nuk lejoheshin të importoheshin në RDGJ," raportojnë zyrtarët. Incidenti më vonë u bë shkas për komente të dyshimta pasi nuk pati ndonjë pasojë negative për Angela Merkel.

"Nuk do ta harroj kurrë debatin që pata me një doganier të RDGJ-së kur u ktheva një herë nga Gdansk se një kartolinë nga monumenti përpara kantierit detar të Gdanskut ishte një provokim politik a thjesht një kartolinë", tha Merkel tridhjetë vjet më vonë. Çdo pjesë e një qyteti mund të shfaqet në një kartolinë, i kishte thënë ajo oficerit, i cili mendonte ndryshe dhe i kishte sekuestruar kartolinën.

"Por Solidarno?? nuk mund ta zhbente atë që kishte ndodhur," theksoi Merkel. "Për ne qytetarët e ish-RDGJ në veçanti, unioni Solidarno??, që prej themelimit në 1980, ka qenë një simbol shprese, për ndryshim dhe shprese për liri që nuk mund të mbahet shtypur për një kohë të gjatë."

### Në Templin mbi politikën

Në RDGJ kjo shpresë jep fryte vetëm ngadalë dhe krejt ndryshe nga sa në Poloni. Forca shtytëse nuk është një lëvizje si Solidarno??. Forcat shtytëse janë grupet e vogla të paqes dhe mjedisit, kryesisht nën ombrellën e Kishës Ungjillore. Ajo është një nga institucionet e pakta ku mund të takohesh lirshëm në seminare, lutje, ose të ashtuquajturat „meshat blues“. Edhe takimet në Templin në Brandenburg, të organizuara nga babai i Merkelit, prifti protestant Horst Kasner, me kalimin e kohës po mblidhnin një pjesë të opozitës së RDGJ-së. "Shumë syresh falë vëllait të Angelës, fizikantit Marcus Kasner", thotë profesori i teologjisë Christofer Frey. Profesori nga Bochumi, i cili është mik i familjes Kasner, udhëheq bisedat, që zgjasin nga një javë e bëhen çdo vit. Angela Merkel merr pjesë herë pas here. Në fund të viteve 1980, kur kohët po bëheshin shumë të pasigurta, teologët dhe shkencëtarët

diskutojnë për demonstratat e mëdha që po vijnë. "Ne debatojmë gjithë natën. A do të ndërhyjë ushtria e RDGJ-së? Apo Bashkimi Sovjetik?", kujton Frey. "Këto takime nuk kishin ndonjë domethënie të drejtpërdrejtë politike, por ato ishin një lloj vetësigurimi dhe natyrisht një vend për shkëmbime të patrazuara", thotë Marcus Kasner. Më vonë, disa nga pjesëmarrësit në këto takime do të luanin një rol të rëndësishëm në revolucionin paqësor të vitit 1989, duke themeluar lëvizje civile dhe një parti të opozitës.

Në Templin ata flasin për paqen, të drejtat themelore dhe ekologjinë, kjo e fundit gjithashtu një temë tabu në shtetin e Erich Honecker-it. Dhe nganjëherë biseda vetiu shkonte te politika dhe ngjarjet në Poloninë fqinje, "në të cilën ne nuk mund të udhëtonim më aq lehtë në atë kohë", kujton Marcus Kasner. Ai nuk merrte pjesë vetë në takimet shkencore në Bachotek, por kishte dëgjuar për to nga e motra."

### "Një shkencëtare e mirë dhe e konsoliduar"

Në Bachotek, Merkel kurrë nuk e vë veten në plan të parë, por megjithatë ajo bie në sy, kujton Karwowski. "Ajo ishte shumë e përkushtuar dhe merrte seriozisht

çdo gjë që bënte," shtoi ai. Ajo është gjithashtu shumë e përgjegjshme. "Disa bënin bisht dhe shkonin me kajak ose për një shëtitje në pyll. Nuk më kujtohet asnjëherë që Angela Merkel të mos ketë shkuar në leksion. Ajo ishte një shkencëtare e mirë dhe e konsoliduar," thotë ish-kolegu polak.

Edhe Grzegorz Chałasiński i kujton me kënaqësi ditët në Bachotek. Që atëherë ai ishte shok me Joachim Sauer, bashkëshortin e Angela Merkel-it. Në vitin 2007 ai i bëri një vizitë çiftit në Berlin, darkuan në apartamentin e tyre në Berlin. Angela Merkel ishte Kancelare Federale për dy vjet në atë kohë. "Kjo ishte një përvojë e shkëlqyer për mua. Ata jetojnë kaq modestisht. Kaluan një mbrëmje të këndshme. Ishte si më parë, pa trysinë e kohës", thotë profesori i kimisë.

### Vizitë në kinema

Në përgjithësi, Merkel udhëtonte me kënaqësi drejt Polonisë në vitet 1980. Kur Karwowski e pyeti një herë se çfarë i pëlqente veçanërisht nga vendi fqinj, ajo iu përgjigj: Ajo kishte mësuar shumë nga polakët dhe takimet verore në Bachotek ishin gjithashtu trajnime politike për të. Por kishte edhe arsye reale, si dobësia e dukshme e Merkelit për

shportat e kashtës. Gjatë rrugës për në Bachotek, ajo blinte rregullisht shporta dhe punime të tjera të thurura, siç kujtojnë shoqëruarit e saj polakë.

Ndoshta ndihej edhe më e lirë në Poloni. Në 1989 Karwowski e çoi kolegen e tij gjermane në kinema. Ku panë adaptimin filmik të romanit "Die Blechtrommel" (Daulla e llamarintë) e Günter Grass. Filmi ishte i ndaluar në RDGJ në atë kohë.


Pas një qëndrimi gjashtë ditor në Poloni, në nëntor 1989, Karwowski e shoqëron Merkelin në stacionin e trenit. Një ditë më parë, ata kishin vizituar degën rajonale të lëvizjes Solidarno??. Merkel aty pa një kuti donacionesh. Më pas, në stacionin e trenit, ajo i jep Karwowski pjesën e mbetur të parave nga udhëtimi dhe i kërkon atij që t'i vendosë në këtë kuti. "Ajo nuk merrte vendime të tilla në mënyrë spontane, nga asgjëja. I mendonte mirë", përfundon profesori, duke vënë në pah një analogji me stilin e qeverisjes së Kancelares së sotme.

### Një takim pas vitësh

Vizita e Merkelit në Torunj në vjeshtë 1989 nuk është takimi i saj i fundit me Jacek Karwowski. Vite më vonë ajo sugjeron një takim në Varshavë. Është viti 2007 dhe Merkel është në krye të qeverisë gjermane. "Ajo është moshuar, por si njeri ishte njëlloj si më parë, e zgjuar dhe me sytë drejt së ardhmes. Vetëm rrobat i kishte ndryshuar. E kishte ndërruar trikon e saj të vjetër me rroba elegante", thotë Karwowski. Ata janë edhe sot miq. Profesori nga Torunji i ruan letrat e saj me kujdes. "Unë jam krenar që e kam njohur dikë që është ndoshta politikanja më e shquar në botë," thotë ai me entuziazëm.

Një grua shteti për të cilën Solidarno??-i ishte një udhërrëfyes, siç theksoi Angela Merkel në një podcast këtë vit me rastin e dyzet vjetorit të lëvizjes sindikale polake. Gratë dhe burrat e Solidarno??-it kishin nisur dhjetë vjet përpara rrëzimit të Murit që ta shtronin rrugën për aktivistët e të drejtave civile në RDGJ. Vullneti i tyre për liri vuri në lëvizje gurë që në fund shembën Murin e Berlinit dhe Perden e Hekurt. / DW





QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Të bashkuar mund të luanim në kompeticionet më të rëndësishme



**TIRANË, 12 NËNTOR** - Ndeshja miqësore në mes të Shqipërisë dhe Kosovës e zhvilluar të mërkurën në Elbasan, i bëri shumë dashamirës të futbollit të mendonin për potencialin që do të kishte një skuadër e bashkuar. "Dardanët" së fundmi po kanë probleme në mbrojtje, teksa Shqipëria për shumë ndeshje para kësaj nuk arrinte ta gjente rrugën për te goli e bashkimi i dy skuadrave do të krijonte një skuadër të përkryer, sipas trajnerit Bylbyl Sokoli. "Profa" në një intervistë për "Sport Ekspres" ka dhënë mendimin e tij se pse

dy skuadrat do të duhej të bashkoheshin. "Ky ishte një takim ku më tepër i kushtuan rëndësi që t'i kënaqnin të ftuarit. Nuk pamë ndonjë rivalitet në fushë. Të dy ekipet nuk treguan ndonjë motiv për ndeshjen, u bënë shumë ndërrime dhe u lanë hapësirë atyre futbollistëve që kanë pasur më pak minuta aktivizimi më parë. Në ndeshjet e fundit të Kosova po mungon fryma e grupit që ka qenë më herët. Cilësia e Kosovës ka qenë loja në grup, e cila do të kthehet kur përbërja të jetë e

kompletuar", ka thënë Sokoli. "Sa iu përket kritikave rreth Zhegrovës, është i ri dhe ka nevojë për punë profesionale dhe pedagogjike. Potenciali i tij është i pamohueshëm dhe duhet të shfrytëzohet. Kjo është puna e trajnerit Bernard Challandes. Vlerësimi përfundimtar i ndeshjes? Pikërisht kjo shpërndarje e cilësisë në dy ekipe nuk mundëson që shqiptarët të kenë një ekip të kualifikuar në Evropian ose Botëror. Një kombëtare është në interesin e shqiptarëve", ka deklaruar Sokoli.

## Subvencionohen klubet sportive në Lipjan

**LIPJAN, 12 NËNTOR** - Nënkrjetari i Komunës së Lipjanit, Fauz Xhemajli dhe drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Anila Llugiqi, sot së bashku me përfaqësuesit e klubeve sportive kanë nënshkruar kontratat për subvencionimin e këtyre klubeve. Nënkrjetari Xhemajli ka thënë se Lipjani po qëndron mirë në sport, ku dihet se tashmë ka klube të cilat po garojnë në Superligë në nivel vendi dhe klube të tjera në ligën e parë. Po ashtu, gjatë këtij takimi është pohuar se subvencionimi i klubeve do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe se klubet sportive do të gjejnë përkrahje të vazhdueshme nga Komuna e Lipjanit. Përfaqësuesit e klubeve sportive kanë falënderuar Komunën e Lipjanit për përkrahjen e dhënë, duke theksuar se kjo është edhe një ndihmesë shtesë që po u bëhet klubeve sportive në Lipjan.



### SHKURT

#### Lazio mendon për huazimin e Muriqit

Reprezentuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, në janar mund të largohet nga skuadra e Lazios. "Transfermarketweb" raporton se klubi nga kryeqyteti italian mund ta huazojë sulmuesin Muriqi në një klub tjetër për të pasur minuta më shumë për pjesëmarrje në lojë. "Të zhgënjyer me performancën e tij në këtë fazë të hershme, menaxhmenti i Lazios mund ta huazojë sulmuesin e Kosovës, Vedat Muriqin, i cili u ble në më pak se dy muaj më parë", shkruan media italiane. Sulmuesi që shënoi gol në ndeshjen miqësore Shqipëri-Kosovë (2-1), ka nënshkruar kontratë me Lazion deri në vitin 2025.

#### Gjendja shëndetësore e Challandesit është e mirë

Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes, është infektuar me koronavirus. Trajneri zviceran ka rezultuar pozitiv me Covid-19 në testin e kryer para ndeshjes miqësore Shqipëri - Kosovë (2-1) e zhvilluar të mërkurën në stadiumin "Elbasan Arena". Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, ka thënë se gjendja shëndetësore e Challandesit është e mirë. "Gjendja shëndetësore e tij është e mirë. Ai nuk ka asnjë problem dhe asnjë simptomë dhe nesër do ta bëjë edhe një test dhe shpresojmë se do të dalë negativ", ka thënë Salihu për "Zeri.info". Kosovën ndaj Shqipërisë e ka drejtuar ndihmësi i Challandesit, Muharrem Sahiti.

#### Bushi infektohet me Covid-19

Shqipëria U21 preket nga Covid-19. Trajneri Alban Bushi, pas tamponit të kryer, ka dalë pozitiv dhe menjëherë është izoluar, sikurse edhe e kërkon protokollin sanitar. FSHF ndërkohë ka vendosur edhe se kush do ta drejtojë kombëtaren në sfidat me Kosovën dhe Anglinë. "Alban Bushi nuk do të jetë në gjendje që ta drejtojë ekipin Kombëtar U-21 në dy ndeshjet e radhës sepse tekniku i 21-vjeçarëve ka dalë pozitiv me Covid-19 pas testimit me tampon. Kundër Kosovës dhe Anglisë, ekipin do ta drejtojë specialisti i njohur dhe një prej ish-trajnerëve të kombëtares shqiptare, Dzemail Mustedanagiq. Në kushtet e emergjencës Federata dhe Drejtoria Teknike kanë vendosur t'ua besojë drejtimin e kuqezinjve, specialistit që ka mbi një dekadë që shërben në Shqipëri", njofton FSHF-ja.

## “Dardanët” stërviten për ndeshjen me Slloveninë

DURRËS, 12 NËNTOR - Pas ndeshjes miqësore që Kosova e humbi nga Shqipëria, futbollistët “dardanë” kanë zhvilluar të enjten stërvitjen për ndeshjen e radhës që e

zhvillojnë të dielën kundër Sllovenisë në Lubjanë. “Në stërvitjen e cila u zhvillua në Shijak ishin të pranishëm 11 futbollistë, kurse pjesa tjetër që luajti më shumë minuta

në miqësore, ka kryer rigjenerim në plazhin e Durrësit. Gëzon fakti se të gjithë futbollistët janë në gjendje të mirë dhe nuk kanë lëndime. ‘Dardanët’ do të

kryejnë edhe sot (e premte) një stërvitje, kurse të shtunën do të nisen për në Slloveni”, thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.



## Do t’i fitojmë ndeshjet e radhës

TIRANË, 12 NËNTOR - Mesfushori Ylber Ramadani ishte një tjetër futbollist që trajneri Edy Reja i kishte besuar aktivizimin nga minuta e parë në ndeshjen miqësore ndaj Kosovës. Futbollisti luajti para mbrojtjes dhe bëri mirë punën si barrikada e parë për aksionet sulmuese të kundërshtarëve, por ndihmoi jo pak edhe në shpërndarjen e topave dhe nxjerrjen e skuadrës përpara. Ramadani të enjten ishte në krah të Bekim Balajt në një konferencë për shtyp nga ambienti i grumbullimit të Kombëtares Shqiptare, ku foli për dy takimet e radhës dhe shprehu gatishmërinë për të luajtur sërish nga minuta e parë.

*A besoni se mund ta përsëritim suksesin edhe në dy ndeshjet e ardhshme?*

**Ramadani:** Janë dy ndeshje shumë të rëndësishme dhe duam ta marrim maksimumin. Duhet t’i marrim me radhë dhe të bëjmë më të mirën, duke luajtur të përqendruar. Besoj se do t’ia dalim të marrim rezultatet që duam.

*Mund të na penalizojnë mungesat për dy takimet e radhës?*

**Ramadani:** Mund të ndikojnë pak, por gjithsesi të gjithë që janë këtu,



janë gati të bëjnë shumë mirë në fushë. Dihet vlerat e atyre që mungojnë, por kemi në grup futbollistë që mund t’i zëvendësojnë dhe të bëjnë po aq mirë. Jemi një grup që punojmë prej kohësh bashkë dhe dimë mirë të përshtatemi me njëri-tjetrin.

*E shikon veten pjesë të formacionit për ndeshjet e radhës?*

**Ramadani:** Unë vij gjithmonë për të luajtur, por formacionin e vendos trajneri. Unë jam gati të bëj më të mirën në stërvitje dhe sa herë të më jepet rasti në fushën e lojës, për të shpërblyer besimin.

### SHKURT

#### Fazliji, pas debutimit me Kosovën: Ndjenjë e papërshtueshme

Betim Fazliji nuk ka fjalë ta përshkruajë ndjesinë e debutimit për Përfaqësuesen e Kosovës. “Dardanët” janë mposhtur nga Shqipëria (2-1) të mërkurën në Elbasan. Në një kohë dilemash mes Zvicrës dhe Kosovës dhe si ish-përfaqësues i ekipit kombëtar U20 të Zvicrës, 21-vjeçari në fund zgjodhi ta përfaqësojë atdheun e vet. Fazliji u lind në Vranje nga prindër shqiptarë të Kosovës. Pavarësisht prej përpjekjeve të Zvicrës për t’i siguruar shërbimet e tij, mbrojtësi premtoi thotë se e kishte ëndërr ta përfaqësonte Kosovën. “Një ëndërr sapo është realizuar. Një ndjenjë e papërshtueshme”, ka shkruar Fazliji në “Instagram”, në mbishkrimin e një fotografie me bashkëlojtarët e tij të Kosova.

#### Unitedi, gati ta shesë në janar Pogban

Manchester Unitedi ka planifikuar ta shesë mesfushorin Paul Pogba. Francezi ka humbur formacionin, pasi trajneri Ole Gunnar Solskjaer nuk po e aktivizon nga minutat e para. Kampioni i botës përdoret vetëm si zëvendësues. “Djajtë e kuq” nuk janë aspak të kënaqur me rendimentin e tij. Ata duan ta shesin në merkaton e janarit, pasi nuk presin shumë nga lojtari. Pogba nga krahu tjetër ka dashur të largohet dhe vetë. 27-vjeçari dëshiron të kalojë te skuadra e Real Madridit. Presidenti Perez nuk e do, ndërsa Juventusit po e monitoron me kujdes situatën. Italianët duan ta rikthejnë në skuadër.

#### Operohet Gomezi

Joe Gomez i është nënshtruar me sukses një operimi pas lëndimit të pësuar në grumbullim të Kombëtarja e Anglisë. Është skuadra e Liverpoolit që ka njoftuar operimin e suksesshëm të mbrojtësit të tyre. Gomez i të mërkurën në grumbullim tek Anglia pësoi një lëndim në gju gjatë seancës stërvitore. Operimi për ta riparuar këtë lëndim është zhvilluar me sukses të enjten në Londër. Liverpooli nuk cek kohën e saktë të mungesës së tij, por thekson se do të mbetet jashtë fushave për pjesën më të madhe të sezonit 2020/2021.

#### Maradona lirohet nga spitali

Diego Maradona është liruar nga spitali pasi kaloi pak më shumë se një javë që kur ai u operua për ta mënjeluar një mpiksje gjaku në trurin e tij. Argentinasi u largua nga klinika në Buenos Aires ku edhe iu kishte nënshtruar ndërhyrjes kirurgjike dhe do të vazhdojë të rikuperohet në shtëpi. Legjenda e Napolit po vuante nga hematoma subdurale, e që është grumbullim i gjakut midis membranës dhe trurit. Ka qenë neurologu i argentinasis, Leopold Luque, ai që ka thënë se e ka dhënë autorizimin për lirin e Maradonës nga spitali.

## Prishtina në raundin e tretë të Kupës Evropiane

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Klubi i Hendbollit Prishtina ka kaluar në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Në raundin e dytë Prishtina është dashur të takohet me skuadrën bullgare Dobrudja. Ndeshjet ishte planifikuar të zhvilloheshin në Prishtinë më 21 e 22 nëntor, ndërsa skuadra kryeqytetase e Kosovës llogaritej favorite për të avancuar në raundin e tretë. Por për shkak të situatës me koronavirus, skuadra bullgare nuk ka qenë në gjendje t’i zhvillojë ndeshjet. Kështu EHF-ja ka vendosur që ndeshjet të anulohen dhe që KH Prishtina të kalojë në raundin e tretë. Prishtina ishte e gatshme për t’i zhvilluar ndeshjet. Madje i ka prituri ato me shumë optimizëm.



Skuadra prishtinase kishte bërë të gjitha përgatitjet për ta prituri skuadrën bullgare, duke u kujdesur që të gjitha kërkesat lidhur me situatën aktuale, të realizohen. Ndeshjet

e raundit të tretë të Kupës Evropiane, Prishtina duhet t’i luajë në dhjetor. Kundërshtarin do ta mësojë pasi të luhen ndeshjet e raundit të dytë dhe të tërhiqet shorti.

## Wilderi, Fury: Bëhu burrë dhe respektoje marrëveshjen për rimeç

Deontay Wilder ka kërkuar nga Tyson Fury që të bëhet burrë dhe ta respektojë klauzolën për trilogjinë mes tyre. Dy boksierët u ndanë baras në meçin e parë, ndërsa në të dytin fitoi

britaniku, i cili ia mori amerikanit titullin WBC në muajin shkurt. Wilderi ka listuar një sërë arsyesimesh për atë humbje dhe mezi pret që të hakmerret ndaj Gypsy King në

duelin e tretë mes tyre. Derisa Fury ka thënë se është shqetësuar për mirëqenien e rivalit të tij, Deontay ka reaguar duke thënë se nuk do asgjë tjetër, pos një meç të radhës me të.

“Hej, Tyson Fury, mos u shqetëso për mua, unë jam mirë, i bekuar. E vetmja gjë që dua nga ti është që ta respektosh marrëveshjen dhe të ndeshesh me mua”. “Të dhashë dy mundësi kur nuk kam

pasur nevojë dhe ta kjo ta ndryshojë jetën. Tash është koha të bëhesh burrë dhe të ma japësh mundësinë ashtu siç jemi marrë vesh”, ka shkruar Wilder në rrjetet sociale.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEÇE "IBËR - LEPENC" D.D.  
Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bill Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

## DOKUMENTI I PARAKUALIFIKIMIT KËRKESA PËR PJESËMARRJE

### Faza e parë

Data kur është përgatitur Dokumenti i Para kualifikimit:

12.11.2020

Prokurimi Nr<sup>1</sup>

IL-SHEE-20-001

Titulli: Shitja e energjisë elektrike

KY DOKUMENT PËRBËHET PREJ KATËR PJESËVE:

- Pjesa I: Udhëzime për Kandidatet
- Pjesa II: Fleta e të Dhënave për Para-kualifikim
- Pjesa III: Formulari i Dorëzimit të Aplikacioneve
- Pjesa IV: Aneksat

Ky dokument është përgatitur në gjuhët Shqipe dhe Serbe

Ne rast se ka mospërputhje në mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës Shqipe mbizotëron.

Ju lutem materialin e plotë lidhur me këtë ankand publik mund ta gjeni në mënyrë të detajuar në formë elektronike në web faqen zyrtare [www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org) të Ndermarrjes Hidroekonomike "Iber Lepenc" Sh. A Prishtinë



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEÇE "IBËR - LEPENC" D.D.  
Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bill Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

## PREDKVALIFIKACIONI DOKUMENTAT ZAHTEV ZA UČEŠĆE

### Prva faza

Datum pripreme predkvalifikacionog dokumenta: 12.11.2020

Br. nabavke<sup>1</sup>

IL-SHEE-20-001

Naziv: **PRODAJA ELEKTRIČNE ENERGIJE**

OVAJ TENDERSKI DOSIJE SASTOJI SE OD ČETIRI DELOVA:

- Deo I: Uputstvo za aplikante;
- Deo II: Lista Podataka Predkvalifikacije.
- Deo III: Formular za prijavu
- Deo IV: Aneksi

Ovaj tenderski dosije urađen je na albanskom, srpskom i engleskom jeziku.

U slučaju da postoji neslaganje između jezičkih verzija, verzija na albanskom jeziku će prevladavati nad drugima.

U obrascu detaljno potražite celokupan materijal u vezi sa ovom javnom aukcijom elektronski na zvaničnoj veb stranici [www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org), Hidroekonomskog preduzeća „Iber Lepenc“





## K O N K U R S

**Pozitat e punës:** Dispeçer Linje – 3 punëtorë/e, prej tyre 2 punëtorë/e me aftësi të kufizuar;  
**Orari i punës-** i plotë  
**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit, me mundësi vazhdimi;

### Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mban evidencën ditore të shoferëve dhe konduktërëve në harmoni me orarin ditor dhe mujor.
- Kujdeset mbi mirëmbajtjen e rregullave të nisjeve sipas orarit dhe siguron linjën e operimit.
- Në rast të mungesës së autobusëve të mjaftuar në linje, kontakton me dispeçerin e bazës dhe monitoruesin për ti ofruar ndihmë me autobus.
- Bënë nënshkrimin e urdhërësive të punës në fillim dhe mbarim të çdo turre, është përgjegjës për nënshkrimet e bëra në urdhërësë.
- I njëjti në shërbimin ekonomik financiar furnizohet me bileta mujore sipas nr. serik dhe mban përgjegjësi me biletat e ngarkuara sipas nr. serik.
- Është i obliguar që me bileta mujore ti furnizoj pasagjerët sipas grup moshave-profesionit dhe çmimeve në to (nxënës, studentë, dhe punëtorë).
- Është i obliguar që nga pasagjerët të kërkoj dokumentacionin përkatës – fotografi, vërtetim etj.
- Është i obliguar që për çdo biletë të dhënë mujore të evidentoj pasagjerin në librin e posaçëm.
- Është i obliguar që për çdo ditë në arkën e ndërmarrjes – te arkëtari të dorëzoj pazarin ditorë për bileta të shitura.
- Kryen edhe punë të tjera me urdhër të Udhëheqësit të Transportit dhe Drejtorit të operatives.
- I raporton U.T.

### Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

- Shkolla e mesme apo fillore;
- Aplikacionin për punësim;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Përvoja e punës përparësi;
- Dëshmi përkatës që dëshmon se aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuar (për aplikantët me aftësi të kufizuar)

### Informata të përgjithshme:

#### Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com);

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse posedon);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi përkatës që dëshmon se aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuar (për aplikantët me aftësi të kufizuar)

-Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

- Forma e vlerësimit dhe procedurat e rekrutimit për personat me aftësi të kufizuar do të zhvillohen varësisht nga aftësia e kufizuar e aplikantit/es dhe mundësitë organizative të ndërmarrjes.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com).

Konkursi është i hapur nga data **13.11.2020** dhe përfundon më datë **27.11.2020** në ora 24:00.

NPK "Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 23

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pravdimiti:	12-11-2020	
Nëmbra Jodica	Numri Broj	Shifra Postale
4-610	56239	

**Njoftimi për shprehje të interesit**  
Emri i shkollës: "Emin Duraku"  
Komuna: Lipjan  
Data: 13.11.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/023-G/1.5	Mjete konkretizimi për klasat 1-9

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

#### 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Mjete konkretizimi për klasat 1-9

#### 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

#### 3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku" Lipjan, më së largu deri më 23.11.2020

#### 4. Specifikimi i hollësishtëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë lutën që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

#### Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues:

Hazbi Sahiti

Telefoni: 044 183-336

E-maili: [hazbi.sahiti@hotmail.com](mailto:hazbi.sahiti@hotmail.com)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Edonis Guci shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI te Sh>M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Mentor Daija shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Laureta Rama shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Gresa Zeka shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII, dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Pashk Gjinaj shpall te pa vlefshme certifikatën e maturës shtetërore ne Sh.M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Tunë Bezhë shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

